



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 4 dhjetor 2017
Nr. ref.: RK 1161/17

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI46/17

Parashtrues

Agjencia Kosovare e Privatizimit

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I.-16-0084, të 14 dhjetorit 2016

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës). Në procedurën në Gjykatën Kushtetuese, parashtruesi përfaqësohet nga Agron Kajtazi, ushtruesi i detyrës së Udhëheqësit të Njesisë për çështje gjyqësore të Departamentit Ligjor të parashtruesit të kërkesës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I.-16-0084 (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit), të 14 dhjetorit 2015, në lidhje me Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, C-I.-16-0001 (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Specializuar), i 30 marsit 2016. Vendimi i Kolegjit të Apelit iu dorëzua parashtruesit të kërkesës më 15 dhjetor 2016.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të sipërpërmendur të Kolegjit të Apelit, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat dhe liritë e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113 (7) dhe 116 (2) të Kushtetutës, në nenet 22, 27 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullat 29 dhe 54 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 14 prill 2017, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 19 prill 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani.
7. Më 27 prill 2017, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe dërgoi një kopje të kërkesës në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Dhoma e Posaçme).
8. Më 7 shtator 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Nga shkresat e lëndës del se në vitin 1973, Ndërmarrja Shoqërore (në tekstin e mëtejme: NSH) "Sanitas", me seli në Mal të Zi, themeloi kompaninë subsidiare që gjendet në Pejë, Kosovë.
10. Më 29 dhjetor 1995, sipas regjistrimit në Gjykatën Ekonomike të Podgoricës, Mali i Zi, bazuar në legjislacionin e Malit të Zi, NSH "Sanitas" u shndërrua në

Shoqëri Aksionare (në tekstin e mëtejshëm: SHA) të quajtur “Unifarm” dhe kompania subsidiare që gjendet në Pejë-Kosovë, u përfshi në atë transformim.

11. Më 2 shkurt 2010, kompania “Unifarm-Pejë” kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që ta konfirmojë statusin e kësaj kompanie si një kompani private.
12. Parashtruesi i kërkesës themeloi një Komision shqyrtues për të raportuar për këtë Kërkesë për Përcaktimin e Statusit (KPS). Raporti i Komisionit shqyrtues arriti në përfundimin se kompania “Unifarm-Pejë” nuk ishte shndërruar në SHA por ishte NSH sipas ligjit të Kosovës dhe prandaj, sipas nenit 5.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, nr. 04/L-034, parashtruesi i kërkesës ishte i autorizuar të administrojë kompaninë “Unifarm-Peja” dhe pasurinë e saj.
13. Më 31 tetor 2013, Bordi i parashtruesit të kërkesës miratoi raportin e Komisionit shqyrtues për KPS.
14. Më 21 ose 25 nëntor 2013, parashtruesi i kërkesës e njoftoi kompaninë “Unifarm-Pejë” për vendimin e saj se kompania ishte NSH nën administrim të parashtruesit të kërkesës.
15. Në korrik të vitit 2014, parashtruesi i kërkesës e njoftoi kompaninë “Unifarm-Pejë” se do të vazhdojë ta likuideojë ndërmarrjen.
16. Ndërmarrja parashtrroi kërkesë në Dhomën e Posaçme kundër vendimit të parashtruesit të kërkesës për likuidim. Kompania gjithashtu kërkoi një urdhër kundër likuidimit. Urdhri u aprovua nga Kolegji i Specializuar dhe u vërtetua nga Kolegji i Apelit.
17. Më 30 mars 2016, Kolegji i Specializuar (C-I.-16-0001) e aprovoi padinë dhe deklaroi se, *“Vendimi i [parashtruesit të kërkesës] për ta vendosur parashtruesin e kërkesës nën administrimin e tij është në kundërshtim me ligjin dhe ndikon në interesin ligjor të paditësit, që është mjaftueshëm për ta anuluar atë vendim.”*
18. Kolegji i Specializuar arsyetoi që:

“Sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, që në thelb kanë mbetur të pakontestuara dhe janë gjithashtu në përputhje me gjetjet e Gjykatës, NSH “Unifarm në Pejë” me asetet e saj, është transformuar, me privatizim, në një shoqëri aksionare në fund të vitit 1995. Kjo ka përfunduar zyrtarisht një procedurë privatizimi të rregulluar me ligjin e Malit të Zi. Pasoja natyrore e këtij transformimi do të ishte që Unifarm Pejë nuk do të ishte më NSH, por në mënyrë retroaktive, në vitin 2002, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2002/12 e kufizon këtë me nenin 5.3, i cili thotë:

5.3 Transformimi i mëvonshëm i ndërmarrjes në formë tjetër të organizatës afariste, ndikon në statusin e saj si ndërmarrje në pronësi shoqërore, vetëm nëse transformimi i tillë është bërë para datës 22 mars 1989 ose, nëse është bërë më vonë, është::

(a) Bazuar në ligjin në fuqi; dhe

(b) Është zbatuar në mënyrë jodiskriminuese,

Transformimi në Malin e Zi ka ndodhur pas datës 22.03.1989, prandaj transformimi preku, sipas dispozitës së lartpërmendur të vitit 2002, vetëm statusin e kompanisë, nëse ishte i bazuar në ligjin në fuqi dhe ishte zbatuar në mënyrë jodiskriminuese,

Mohimi retroaktiv i efekteve juridike të këtij transformimi do të sillte një sërë çështjesh ligjore, por ato nuk duhet të shqyrtohen, sepse dy kushtet për njohjen e transformimit - së pari duke u bazuar në ligjin e aplikueshëm dhe së dyti duke u zbatuar në mënyrë jo-diskriminuese - janë përmbushur. Për të njëjtën arsye nuk duhet të diskutohet nëse kompetencat e UNMIK-ut parashihnin mbizotërimin e Ligjit të Malit të Zi ose ishte kufizuar në Ligjin në Kosovë.”

19. Më 26 prill 2016, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Kolegjin e Apelit.
20. Më 14 dhjetor 2016, Kolegji i Apelit (AC-I.-16.0084-A001) refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi vendimin e Kolegjit të Specializuar.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

21. Parashtruesi i kërkesës pretendon se aktgjykimet e kontestuarra kishin shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të mbrojtura me nenin 102 (3) [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës, sepse Kolegji i Apelit dhe Kolegji i Specializuar zbatuan ligjet e Malit të Zi gjatë gjykimit të çështjes, ndërsa neni 102 (3) i Kushtetutës i obligon gjykatat të zbatojnë vetëm Kushtetutën dhe ligjet e aplikueshme në Kosovë.
22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se kompania “Unifarm-Pejë” është një NSH sipas ligjit në fuqi në Kosovë, dhe prandaj bie nën administrimin ekskluziv të parashtruesit të kërkesës, siç konfirmohet me vendimin e Bordit të parashtruesit të kërkesës më 31 tetor 2013. Kolegji i Specializuar dhe Kolegji i Apelit, gjatë gjykimit të çështjes, konstatoi se NSH-ja ishte shndërruar në 1995 në një Shoqëri Aksionare dhe përdori ligjet që zbatoheshin në Mal të Zi në 1995 për të justifikuar përfundimin e tyre.
23. Parashtruesi i kërkesës pretendon se transformimi në vitin 1995 i kompanisë në pronësi shoqërore “Unifarm-Pejë” në një Shoqëri Aksionare nuk është e vlefshme sipas ligjeve të zbatueshme në Kosovë sot, dhe se në arritjen e vendimeve të tyre, Kolegji i specializuar dhe Kolegji i ankesave kanë aplikuar ligjet e Malit të Zi, në kundërshtim me nenin 102 (3) të Kushtetutës.
24. Në veçanti, parashtruesi i kërkesës pretendon se:

“Në Kosovë të ligjshëm për transformimin e pronës së një NSH-je apo një aseti të NSH-së, në periudhën që pretendon se paditësi është bërë Shoqëri

Aksionare, kanë qenë Ligji mbi Ndërmarrjet i RSFJ- se 77/88, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjet e RFSJ- së Nr. 40/89,46/90 dhe 61/90. Ndërsa Kolegji i Apelit dhe Kolegji i Specializuar këtë fakt fare nuk e merr në konsideratë, dhe jep arsye se ky transformim ishte bërë në Mal të Zi, në kohën e ekzistimit të ish-Jugosllavisë, në të cilën bënte pjesë edhe Kosova, andaj transformimi i kësaj Njësie në Pejë të “Unifarmit-it” nga Podgorica, është bërë konform ligjeve që kanë pasur një vlerë juridike në hapësirën dhe kohën e aktualitetit të atëhershëm. Për më tepër, Kolegji i Apelit dhe Kolegji i Specializuar kanë dështuar të përcaktojnë nëse janë ndjekur procedurat e rregullta sipas ligjeve të zbatueshme në atë kohë.”

25. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimet e kontestuara është shkelur e drejta e tij për mbrojtjen e pronës, siç garantohet me nenin 46 (1) [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, sepse, pas 10 qershorit 1999, NSH-ja nuk kishte më të drejtën ligjore për të tjetërsuar pronën shoqërore në territorin e Kosovës, sepse sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/54, parashihet që UNMIK-u të administrojë pasurinë e luajtshme ose të paluajtshme që është në territorin e Kosovës, duke përfshirë financat, llogaritë bankare dhe pronat tjera, ku UNMIK-u ka baza të arsyeshme dhe objektive për të konkluduar se prona e tillë është pronë shoqërore.
26. Parashtruesi i kërkesës pretendon se, sipas Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit të 31 gushtit 2011, ai ka kompetenca ekskluzive për të administruar NSH-të dhe pronën e tyre.
27. Parashtruesi kërkon nga Gjykata që:
 - I. Ta deklarojë kërkesën e parashtruesit të pranueshme; dhe
 - II. Të anulojë Aktgjykimin e Kolegjit të Ankesave pranë DHPGJSK, AC-I-16-00B4, i 14 dhjetorit 2016, dhe Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar DHPGJSK, C-I-16-0001, i 30 marsit 2016.
28. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme për të parandaluar paditësit në NSH nga tjetërsimi i çdo prone të NSH-së, veçanërisht që të obligojë “Unifarm A. D. za medicisko snabdevanje sa p. o. Podgorica-Poslovna Jedinica Peć”, që mos t’ua transferojë parcelën nr. P-71611071-05092/1, Certifikata nr.-16 - 191313, ZK Pejë, palëve të treta, derisa Gjykata të marrë një vendim lidhur me këtë kërkesë.

Ligji relevant

29. Puna dhe funksionet e parashtruesit të kërkesës rregullohen me Ligjin nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit të 31 gushtit 2011, nenet 1, 2 dhe 5, të të cilit parashohin që:

Kreu I -Statusi Ligjor, Qëllimet Dhe Përkufizimet

Neni 1 Themelimi dhe statusi ligjor i Agjencisë Kosovare të Privatizimit

“1. Agjencia Kosovare e Privatizimit (më tej “Agjencia”) është organ i pavarur publik i cili i ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në mënyrë plotësisht autonome. Agjencia ka zotësi të plotë juridike, posaçërisht për të bërë kontrata, për të marrë, mbajtur ose shitur pronën, si dhe ka të gjitha kompetencat e vetëkuptueshme për përmbushjen në tërësi të detyrave dhe kompetencave të dhëna me këtë ligj; si dhe të padisë e të paditet në emër të saj.

2. Agjencia është pasardhëse e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) që është themeluar dhe rregulluar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 “Mbi Themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit”, dhe të gjitha asetet dhe përgjegjësitë e saj do të jenë asete dhe përgjegjësi të Agjencisë.”

Neni 2 Synimi dhe qëllimi

“1. Në pajtim me kushtet e përcaktuara në këtë ligj, Agjencia është e autorizuar për administrimin, duke përfshirë autorizimin për shitjen, transferimin dhe/ose likuidimin e ndërmarrjeve dhe asetëve të përkufizuara në këtë ligj.

2. Për realizimin e këtij synimi, Agjencia:

2.1. deri në shitjen ose zgjidhjen në mënyrë tjetër sipas këtij ligji, mban dhe administron secilën ndërmarrje dhe asete në mirëbesim dhe në të mirë të pronarëve dhe kreditorëve të tyre, në përputhje me këtë ligj dhe dispozitat tjera të zbatueshme të së drejtës së Kosovës;

2.2. shet, transferon ose likuidon ndërmarrjet dhe asetet në përputhje me nenet 6, 8 dhe 9 të këtij ligji, pa vonesa të panevojshme;

2.3. brenda kufizimeve të burimeve të veta administrative, ushtron aktivitete të arsyeshme ndihmëse për ruajtjen ose rritjen e vlerës, aktivitetit fitimprurës dhe qeverisjes së ndërmarrjeve dhe asetëve, deri në masën sa këto aktivitete nuk e pengojnë ushtrimin e detyrave të përcaktuara në nën-paragrafin 2.2 të këtij paragrafi;

2.4. në mënyrën dhe masën e paraparë në këtë ligj, përmbush pretendimet e vlefshme dhe të dorëzuara me kohë të kreditorëve dhe pronarëve lidhur me një ndërmarrje apo asete të caktuar, nga mjetet e realizuara nga shitja, transferimi, likuidimi ose zgjidhja tjetër e ndërmarrjes ose asetit; me ç'rast të gjitha këto të ardhura me përjashtim të Fondeve Tepricë do të mbahen në mirëbesim për pronarët dhe kreditorët dhe do të ruhen nga Agjencia;

2.5. pas skadimit të afatit të dhënë për dorëzimin e pretendimeve të pronarëve dhe kreditorëve, në pajtim me nenin 19 paragrafi 3., kryen identifikimin dhe bartjen e të gjitha Fondeve Tepricë të cilat mbahen në mirëbesim nga Agjencia në Qeverinë e Kosovës;

2.6. kryen detyra të tjera të cilat i janë dhënë sipas këtij ligji dhe dispozitave tjera ligjore të zbatueshme në Kosovë.

3. Ky ligj do të zbatohet në përputhje me parimet e parashtruara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokollet e saj.”

Kreu II - Detyrat Dhe Kompetencat e Agjencisë

Neni 5 Ndërmarrjet dhe asetet nën autoritetin administrativ të agjencisë

“1. Agjencia ka kompetenca ekskluzive që të administrojë:

1.1. ndërmarrjet në pronësi shoqërore, pavarësisht nëse i janë nënshtruar transformimit apo jo;

1.2. të gjitha asetet që ndodhen në territorin e Kosovës, pavarësisht a janë të organizuara si subjekte apo jo, të cilat kanë qenë pronë në pronësi shoqërore me ose pas 22 marsit 1989, përveç rasteve të rregulluara sipas paragrafit 2. të këtij neni; dhe

1.3. të gjitha aksionet në korporata dhe korporatat vartëse të themeluara sipas këtij ligji; dhe të gjithë interesat në pronësi shtetërore në një ndërmarrje apo subjekt tjetër juridik, pavarësisht nëse ajo ndërmarrje apo subjekt juridik i është nënshtruar transformimit.

2. Nëse një rregullore ose ligj që është në fuqi dhe që është shpallur nga një autoritet kompetent publik në Kosovë pas 10 qershorit 1999 i cakton përgjegjësinë për administrimin e aseteve të përcaktuara në nënparagrafi 1.2. të paragrafit 1. të këtij neni një organi tjetër publik, Agjencia nuk do të ketë autoritet mbi këto ndërmarrje duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të atij ligji ose rregulloreje.

3. Autoriteti administrativ i Agjencisë i paraparë në nenin 5 paragrafi 1.1. do të vlejë për të gjitha pronat në pronësi apo posedim të ndërmarrjes, përfshirë pronat që gjenden jashtë Kosovës; me kusht që - dhe pavarësisht nga detyrimet e Agjencisë të përcaktuara në nenin 2 paragrafi 1 - lidhur me ato prona që gjenden jashtë Kosovës, Agjencia i kërkohet vetëm të ushtrojë autoritetin e vet mbi ato prona deri në masën që Agjencia e konsideron të arsyeshme, duke marrë parasysh vlerën dhe qasjen ndaj këtyre pronave dhe kufizimet e burimeve administrative të Agjencisë siç referohen në nenin 7.1. të këtij ligji. Gjatë vendimmarrjes mbi këto çështje, Agjencia merr parasysh të gjitha politikat përkatëse të cilat mund të miratohen nga Qeveria ose Kuvendi i Kosovës.

4. Nëse ndërmarrja i është nënshtruar transformimit, ky transformim nuk do të ndikojë në të drejtat dhe kompetencat e Agjencisë sipas paragrafit 1. dhe 2. të këtij neni si dhe neneve 6, 8 ose 9 të këtij ligji, përveç nëse:

4.1. transformimi është bazuar dhe është kryer në përputhje të plotë me ligjin në bazë të cilit është bërë transformimi;

4.2. janë përmbushur të gjitha obligimet që ndërlidhen me transformimin, qofshin ato që kanë dalë gjatë apo pas transformimit, qofshin ato të shqiptuara në bazë të ligjit apo ndonjë kontrate – përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në, përmbushjen e plotë të detyrimeve që kërkojnë pagesën e kompensimit të plotë dhe lëshimin e aksioneve; dhe

4.3. transformimi nuk ka qenë diskriminues dhe nuk i ka shkelur parimet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut,

5. Gjatë ushtrimit të të drejtave dhe kompetencave të saj sipas neneve 6, 8 dhe 9 të këtij ligji në lidhje me një ndërmarrje e cila i është nënshtruar transformimit, Agjencia ka të drejtë të supozojë se transformimi nuk i përmbush të gjitha kushtet e përcaktuara në paragrafin 4. të këtij neni, përveç nëse Agjencia ka në dispozicion prova bindëse të gatshme të cilat vërtetojnë se transformimi i përmbush këto kushte. Në raste të kështilla zbatohet paragrafi 6. të këtij neni.

6. Nëse, në përputhje me paragrafin 5. të këtij neni, Agjencia konstaton se transformimi i një ndërmarrjeje ose aseti i përmbush të gjitha kushtet e përcaktuara në paragrafin 4, dhe Agjencia nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim më parë sa i përket ndërmarrjes së tillë apo ndonjë aseti të saj sipas nenit 6.2. të këtij Ligji, zbatohen rregullat në vijim:

6.1. nëse agjencia ka prova të qarta të gatshme në dispozicion, të cilat në mënyrë bindëse e bëjnë ndarjen e të drejtave (ose pronësisë) të aksionarëve mbi ndërmarrjen, ndërmjet kapitalit shoqëror (ose pronësisë) dhe kapitalit privat (ose pronësisë), Agjencia do ta ndërpresë ushtrimin e autoritetit mbi këtë ndërmarrje përveç për qëllime të ushtrimit të të gjitha të drejtave të aksionarit (ose pronësisë) që dalin nga kapitali në pronësi shoqërore (pronësi) mbi një pjesë të kapitalit të përgjithshëm të ndërmarrjes, që përfshinë të drejtën për të shitur ato të drejta të aksionarit (pronësisë); dhe

6.2. në mungesë të këtyre provave, për ato ndërmarrje Agjencia do të vazhdojë të ushtrojë të drejtat dhe kompetencat e saj sipas neneve 6, 8 dhe 9 të këtij ligji.

7. Të gjitha çështjet që ndërlidhen me apo që shfaqen në lidhje me likuidimin e një ndërmarrjeje apo korporate nën autoritet të agjencisë sipas nenit 6, paragrafi 2.1. të këtij ligji, përfshirë, mes tjerash, përcaktimin e vlefshmërisë së çdo pretendimi të bërë nga një kreditor i supozuar apo çdo pohim për barazi në interesat e pronësisë i bërë nga një pronar i supozuar dhe përcaktimin e shpërndarjes së duhur së të ardhurave të kreditorëve dhe pronarëve, janë përgjegjësi të autoritetit përkatës të likuidimit, i cili respekton rregullat e përcaktuara në shtojcën 1 të këtij ligji. Çdo person që parashtron një pretendim apo pohon një interes të tillë i cili nuk pajtohet me përcaktimin e autoritetit të likuidimit

që prekë atë pretendim apo interes të pohuar, ka të drejtën që t'i sfidojë ato përcaktime pranë Dhomës së Posaçme duke iu përmbajtur kërkesave procedurale të parapara në nenin 37.7 të Shtojcës 1 të këtij ligji.”

Pranueshmëria e kërkesës

30. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

31. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrënë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

32. Gjykata së pari konsideron se në bazë të nenit 21 (4) të Kushtetutës, i cili parasheh që *“Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme”*, parashtruesi ka të drejtë të paraqesë ankesë kushtetuese, duke iu referuar të drejtave themelore të cilat janë të vlefshme për individët, si dhe për personat juridikë (Shih, *mutatis mutandis*, Aktvendimi i 27 janarit 2010, Kërkesa KI41/09, Universiteti AAB-RIINVEST, L.L.c, Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës).

33. Gjykata i referohet edhe nenit 49 [Afatet] të Ligjit, i cili parasheh se:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor.”

34. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, ka shteruar mjetet juridike në dispozicion dhe ka parashtruar kërkesën brenda afatit ligjor.

35. Megjithatë, Gjykata i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili parasheh që:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

36. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu i referohet paragrafëve (1) (d) dhe (2) (d) të rregullit 36 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, të cilët parashikojnë që:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

d) kërkesa arsyetohet *prima facie* ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi e pabazuar, nëse bindet se:

[...]

d) *parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij*”.

37. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimet e kontestuara të Kolegjit të Apelit dhe Kolegjit të Specializuar i janë shkelur të drejtat e tij sipas nenit 102 (3) të Kushtetutës.

38. Gjykata rikujton se neni 102 (3) [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] thekson se:

“3. Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit.”

39. Gjykata rikujton se neni 102 i Kushtetutës bie në Kapitullin VII [Sistemi i Drejtësisë] të Kushtetutës. Si i tillë, Gjykata konsideron se dispozitat e nenit 102 të Kushtetutës nuk përmbajnë të drejta dhe liri individuale të mbrojtura me dispozitat e Kapitullit II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe Kapitulli III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se neni 102 nuk mund të thirret në një kërkesë të bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës.

40. Megjithatë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se Kolegji i Specializuar dhe Kolegji i Apelit kishte shkelur të drejtat e tij për shkak të mënyrës së gjykimit të rastit lidhur me të drejtat dhe detyrimet e parashtruesit në lidhje me kompaninë “Unifarm-Peja”.

41. Shikuar në këtë dritë, Gjykata konsideron se, në thelb, parashtruesi i kërkesës ankohet për shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij. Gjykata rikujton se e drejta për gjykim të drejtë mbrohet me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 6 (E drejta për gjykim të drejtë) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).

42. Gjykata rikujton nenin 31 (2) të Kushtetutës, i cili përcakton:

“2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.”

43. Gjykata gjithashtu përkujton nenin 6 (1) të KEDNJ, në të cilin në pjesët e tij relevante përcaktohet:

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e

paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile [...].

44. Gjykata gjithashtu rikujton që në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës “*Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.*”
45. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton edhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së e cila, *mutatis mutandis*, ka konstatuar që: “*juridiksioni i saj për të verifikuar se ligji i brendshëm është interpretuar dhe zbatuar në mënyrë korrekte është i kufizuar dhe se nuk është funksioni i saj të zërë vendin e gjykatave vendore, roli i saj është të sigurojë që vendimet e këtyre gjykatave nuk janë arbitrare ose qartazi të paarsyeshme*”. Shih rastin e GJEDNJ-së, *Anheuser-Busch Inc. v. Portugal*, kërkesa nr. 73049/01, Aktgjykim i 11 janarit 2007, paragrafi 83.
46. Gjykata gjithashtu rikujton që “[...] [GJEDNJ] nuk do të ngrejë pyetje të interpretimit të ligjit vendor nga gjykatat vendase, përveç në rast të arbitraritetit të dukshëm (shih, *mutatis mutandis*, *Adamsons kundër Letonisë*, nr. 3669/03, paragrafi 118, 24 qershor 2008), me fjalë të tjera, kur vëren se zbatimi i ligjit nga gjykatat vendase në raste të caktuara, është qartazi i gabuar ose janë marrë konkluzione arbitrare dhe/ose u mohohet drejtësia (shih, *mutatis mutandis*, *Farbers dhe Harlanova kundër Lituanisë (vendimi)*, numër 57313/00, 6 shtator 2001, dhe megjithëse në kontekstin e nenit 1 të Protokollit nr. 1, *Beyeler kundër Italisë [DHM]*, numër 33202/96, paragrafi 108, GJEDNJ 2000-I.” Shih rastin e GJEDNJ-së *Andjelković kundër Serbisë*, Kërkesa nr. 1401/08, Aktgjykimi i 9 prillit 2013, para. 24.
47. Në dritën e si më sipër, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave apo zbatimit të ligjit (ligjshmëria), përveç dhe për atë që ato të mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Në të vërtetë, është detyrë e gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. Shih: *mutatis mutandis*, rasti i GJEDNJ-së, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, para. 28.
48. Gjykata vëren se në aktgjykimin e tij, Kolegji i Apelit deklaroi që se ai nuk kishte zbatuar ligjet e Malit të Zi gjatë gjykimit të çështjes së parashtruesit të kërkesës. Në vend të kësaj, Gjykata e Apelit arsyetoi që:
- “Çështja në këtë kontest është mashtruese sepse çështja në fjalë nuk ka të bëjë me zbatimin e ligjit të Malit të Zi në Kosovë, por për njohjen e zbatimit të ligjit të Malit të Zi (lidhur me privatizimin) në Kosovë.”*
49. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Kolegji i Apelit e ka zbatuar gabimisht ligjin, sepse thjesht nuk e ka “njohur zbatimin e ligjit të Malit të Zi”, por, në fakt, ka zbatuar ligjin e Malit të Zi kur arriti në përfundimin se transformimi i “Unifarm-Peja” në një Shoqëri Aksionare ishte në përputhje me ligjin.

50. Gjykata rikujton që neni 4 i Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit të 31 gushtit 2011, lejon transformimin e NSH-ve në shoqëri aksionare që kanë ndodhur ndërmjet 22 marsit 1989 dhe 10 qershorit 1999, me kusht që ky transformim të ketë qenë në pajtim me një numër të caktuar kriteresh.
51. Në rastin në fjalë, Gjykata vëren se Kolegji i Specializuar dhe Kolegji i Apelit konkluduan që transformimi i “Unifarm-Peja” që u bë në vitin 1995 ishte në përputhje me kriteret ligjore të përcaktuara në Ligjin Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Edhe Kolegji i Specializuar edhe Kolegji i Apelit kanë ofruar arsytetime për të mbështetur interpretimin e tyre të ligjit. Si i tillë, vendimet e kontestuara të gjykatave të rregullta kanë marrë parasysh ligjin i cili ishte zbatuar në lidhje me pretendimet e parashtruesit të kërkesës.
52. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se arsyetimet e dhëna nga Kolegji i Specializuar dhe Kolegji i Apelit me rastin e vendosjes lidhur me kërkesat e parashtruesit janë të qarta, gjithëpërfshirëse dhe koherente dhe se procedurat në gjykatat e rregullta nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare (Shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 30 qershorit 2009, *Shub kundër Lituaniës*, nr. 17064/06).
53. Prandaj, Gjykata konkludon se parashtruesi nuk e ka mbështetur pretendimin e tij për shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të mbrojtur me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNJ-së.
54. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon shkelje të të drejtave të tij të mbrojtura me nenin 46 (1) [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës. Parashtruesi i kërkesës pretendon se, në bazë të Ligjit nr. 04/L-034, ai ka kompetencë ekskluzive për të administruar NSH-të dhe asetet e tyre në territorin e Kosovës.
55. Gjykata rikujton që neni 46 (1) i Kushtetutës, parasheh që:
- “1. E drejta e pronës është e garantuar”*
56. Gjykata vëren se neni 2 (1) i Ligjit nr. 04/L-034 i siguron parashtruesit të kërkesës kompetencën që të, “[...] *mban dhe administron secilën ndërmarrje dhe aset në mirëbesim dhe në të mirë të pronarëve dhe kreditorëve të tyre, në përputhje me këtë ligj dhe dispozitat tjera të zbatueshme të së drejtës së Kosovës*”.
57. Si i tillë, Gjykata vëren se autoriteti i parashtruesit ka të bëjë me administrimin “në mirëbesim” për pronarët aktualë të NSH-ve dhe aseteteve të tyre. Parashtruesi i kërkesës nuk ka shpjeguar se si ky autoritet është ekuivalent me të drejtën e “pronësisë” siç garantohet me nenin 46 të Kushtetutës.
58. Prandaj, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* dhe as nuk i ka mbështetur pretendimet e tij që do të tregonin se si dhe pse Kolegji i Apelit kishte shkelur të drejtën e tij në pronë, siç garantohet me këtë dispozitë.

59. Në përfundim, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur fakte që tregojnë se vendimet e gjykatave të rregullta kanë shkaktuar në ndonjë mënyrë shkelje kushtetuese të të drejtave të garantuara me Kushtetutë.
60. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 36, paragrafët (1) (d) dhe (2) (d) të Rregullores së punës.

Kërkesa për masë të përkohshme

61. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës ka kërkuar masë të përkohshme ashtu që asnjë aset i NSH-së të mos tjetërsohet derisa të merret vendimi i Gjykatës lidhur me këtë kërkesë.
62. Gjykata rikujton rregullin 55 (4) (a) të Rregullores së punës, i cili parasheh që:
*“(4) [...] Para se Kolegji shqyrtues të mund të rekomandojë pranimin e kërkesës për masë të përkohshme, ai duhet të konstatojë që:

(a) pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës.”*
63. Pasi konstatoi se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata e refuzon kërkesën për masë të përkohshme.

PËR KËTO ARSYE


Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113, paragrafët 1 dhe 7, të Kushtetutës, nenin 46 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) (d), (2) (d) dhe 55 (4) (a) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 7 shtator 2017, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TA REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;
- III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Ivan Čukalović



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

